

L I G J
Nr.8538, datë 21.10.1999

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË TË DANIMARKËS PËR ASISTENCËN NË PERIUdhËN E TRANZICIONIT”

Në mbështetje të neneve 81 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:
Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Danimarkës për asistencën në periudhën e tranzicionit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.2476, datë 4.11.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE
MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË TË DANIMARKËS MBI ASISTENCËN NË PERIUdhËN E TRANZICIONIT

Duke u udhëhequr nga marrëdhëniet e mira që ekzistojnë dhe me qëllim që të zgjerojnë më tej bashkëpunimin midis tyre Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Danimarkës kanë rënë dakord që asistencë të kryhet në përputhje me nenet e kësaj Marrëveshjeje që vijojnë si më poshtë.

Neni 1
Përcaktime:

Për qëllimin e kësaj marrëveshjeje termat e përmendura nënkuptojnë si më poshtë, në qoftë se nuk shprehen ndryshe:

a) Termi “autoritet kompetent” nënkupton, në rastin e Qeverisë së Danimarkës, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Institucionin e Asistencës Teknike Daneze (Danida) dhe në rastin e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, Ministrinë e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë ose, për të dyja Palët, çdo autoritet tjetër, i cili është i autorizuar që të kryejë të gjitha veprimet që aktualisht kryen nga Autoriteti i përmendur.

b) “Palët nënkuptojnë Autoritetet kompetente.

c) “Termi Program Dokumenti” nënkupton dokumentin që me nënshkrimin e tij është miratuar nga Palët. Program Dokumenti përmban një përshkrim sistematik të programit dhe do të shërbejë për menaxhimin e procesit të zbatimit të programit.

Neni 2
Objektivat e Programit

Objektivi i përgjithshëm i zhvillimit me të cilin është i lidhur programi është:

- Të mbështesë procesin e reformës politike, ekonomike dhe sociale, si dhe demokratizimin e

Republikës së Shqipërisë.

Objektivat imediate të programit janë:

- të përmirësojë funksionimin e sistemit gjyqësor duke krijuar një mjedis të përshtatshëm pune, trajtimin dhe supervisionin e duhur;
- të përmirësojë arsimimin, menaxhimin dhe trajtimin në sistemin policor, si dhe mjedisin në punë;
- të mbështesë zhvillimin e medias dhe shtypit të lirë;
- të mbështesë dhe të nxisë demokratizimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri;
- të mbështesë projektet në sektorin social.

Neni 3

Mënyra e realizimit

Me qëllim që të arrihen objektivat imediate të sipërpërmendura, programi synon të realizojë:

- vendosjen e një projekti pilot në zonën e Dibrës me qëllim përmirësimin e mjedisit juridik dhe policor;
- ngritjen e Zyrës së Ombudsman (Avokati i Popullit);
- përmirësimin e funksionimit të Prokurorisë së Përgjithshme;
- përmirësimin e funksionimit të Komisionit të Inspektorëve Juridikë;
- përmirësimin e funksionimit të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tiranës;
- mbështetjen e kurseve në Shkollën e Magjistraturës;
- krijimin e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit duke përfshirë formulimin e një Kodi Sjelljeje për median.

Neni 4

Program Dokumenti

Program Dokumenti do të nënshkruhet nga të dyja Palët përpara fillimit të zbatimit. Ai do të rishikohet dhe rifreskohet në përputhje me misionet vjetore të rishikimit. Ndryshimet në Program Dokument janë subjekt i miratimit nga të dy Palët.

Neni 5

Detyrimet e Qeverisë Shqiptare

Sipas kësaj marrëveshjeje Qeveria e Shqipërisë:

- a) do të informojë me shpejtësi Danida-n për çdo kusht që influencon ose rrezikon të influencojë në zbatimin e suksesshëm të programit ose të projekteve;
- b) do të sigurojë fonde për pagesën e tvsh, taksave doganore dhe koston vendore për zbatimin e programit;
- c) do të japë mendimet e saj për gjithë skicat, vizatimet, raportet, rekomandimet dhe çështjet e tjera që do t'i kërkojnë për këshillimin nga Danida brenda një kohe të arsyeshme me qëllim që të mos vonojë ose të ndërpresë ekzekutimin e shërbimeve ose të punëve;
- d) do të sigurojë një staf të mirë të kualifikuar me përvojën e nevojshme dhe kompetencë për projektin pilot.

Neni 6

Detyrimet e Qeverisë së Danimarkës

Qeveria e Danimarkës do të sigurojë financimin për veprimtaritë e rena dakord deri në 64.8 milionë Korona Daneze për një periudhë 36 mujore siç parashikohet në Program Dokument.

Asnjë fond i pasqepenzuar apo kursim nga fondet e programit nuk mund të shpenzohet pa miratimin e Autoriteteve kompetente. Shuma e grantit është e shprehur në Korona Daneze (DKK) dhe përfitimet që vijnë si rezultat i ndryshimeve në kurset e këmbimit ose interesave rritëse të dërgesave të fondeve, nuk mund të shpenzohen nga ky program.

Pajisjet etj. do të blihen direkt nga Danimarka, me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndryshe.

Një koordinator danez i përhershëm i programit, si dhe këshilltarët teknikë afatshkurtër do të paguhën nga fondet e këtij programi.

Neni 7

Transportimi

Të gjitha transportimet, që mbulohen nga kjo marrëveshje, do t'i përmbahen parimit të qarkullimit të lirë të anijeve në tregtinë ndërkombëtare sipas një konkurrence të lirë dhe të ndershme.

Neni 8

Importi, taksat e importit, si dhe detyrime dhe tarifa të tjera publike

Qeveria Shqiptare do të sigurojë importimin dhe zhdoganimin në kohë të të gjitha mallrave që mbulohen nga kjo marrëveshje, e cila ka të përfshirë një listë materiale që do të importohen nga kontraktorët sipas specifikimeve në kontratat e punës. Palët duhet të sigurojnë që Grandi Danez nuk do të përdoret për pagesën e çfarëdo takse doganore importi, takse tjetër, mbitaksa kombëtare ose publike si mbitaksa importi, akcizë, komisione të lidhura me kryerjen e pagesave, të lejeve të punimeve, për licenca të ndryshme ose licencave për importin e mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit nga Danimarka për veprimtaritë e rena dakord.

Neni 9

Statusi i personelit të huaj

1. Qeveria Shqiptare do të marrë masa për përjashtimin e personelit të huaj si afatshkurtër, ashtu dhe atij afatgjatë nga:

a) të gjitha taksat, përsa i takon çdo pagesë të kryer ndaj tyre nga burimet daneze;

b) të gjitha detyrimet dhe taksat e vendosura mbi importin dhe eksportin e mallrave shtëpiake të reja ose të përdorura, si dhe mallrave të përdorimit vetjak të importuara nga këshilltarët dhe familjet e tyre për përdorim ekskluziv nga vetë ata brenda 6 muajve nga dita e ardhjes dhe që do të jenë subjekt rieksperti në përfundim të shërbimit të tyre ose pagesës së detyrimeve dhe taksave nëse ato do të shiten;

c) të gjitha detyrimet dhe taksat të vendosura mbi importin dhe eksportin e mjeteve motorrike të transportit, për përdorim vetjak të këshilltarëve, ose për blerjen e mjeteve të tilla në Shqipëri në sistemin e "duty free", duke siguruar që një mjet i tillë i importuar sipas këtyre privilegjeve do t'i përgjigjet detyrimeve dhe taksave, nëse i shitet një personi shqiptar që nuk gëzon privilegjet e mësipërme. Në rastet kur mjeti i importuar dëmtohet dhe riparimi është i pamundur ose kur humbet jo për shkak të pakujdesisë së këshilltarit. Qeveria Shqiptare do të lejojë që të importojë një tjetër mjet motorrik të lirë nga taksat doganore dhe taksat për këshilltarët që kanë përfunduar afatin 3-vjeçar, në qoftë se kontrata zgjatet për katër ose më shumë vjet.

2. Qeveria e Shqipërisë do të japë ndihmesën e saj në zhdoganimin e mallrave të përmendura në pikat 1.b) dhe 1.c).

3. Qeveria e Shqipërisë do të lejojë çdo konsulent të mbajë një llogari të jashtme. Përsa i përket riatdhesimit të të ardhurave nga shitja e mjeteve të motorrizuara të këshilltarëve, këshilltarët do të aplikojnë veçmas në Bankën Kombëtare Shqiptare dhe aplikimet e tyre do të trajtohen në përputhje me rregullat e kontrollit të shkëmbimeve të huaja që janë në fuqi në kohën e largimit të këshilltarëve.

Neni 10

Informimi, monitorimi dhe vlerësimi

1. Palët do të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar përmbushjen e qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim Palët do të shkëmbejnë pikëpamjet e tyre përsa i takon çështjeve që lidhen me programin dhe do t'i sigurojnë njëri-tjetrit të gjitha të dhënat e nevojshme, dokumentaiconin dhe informacionin e vlefshëm për ta, do të japin gjithë asistencën e dyanshme të kërkuar, për zbatimin

e detyrimeve të Palëve dhe të sigurojnë gjithë mbështetjen e nevojshme, veçanërisht në të gjitha çështjet administrative, për të lehtësuar zbatimin e programit.

2. Rishikimet e përbashkëta të projektit Danezo-Shqiptar do të kryhen në përputhje me Program Dokumentin ose me kërkesën e çdonjërës nga Palët.

3. Danida do të ketë të drejtën të kryejë çdo mision teknik ose financiar që ajo e konsideron të nevojshëm për ndjekjen e ekzekutimit të programit. Për të lehtësuar punën e personave ose të personit të udhëzuar për të kryer një mision të tillë monitorimi, Qeveria e Shqipërisë do të sigurojë të gjithë asistencën përkatëse, si dhe informacionin dhe dokumentacionin.

4. Vlerësimi i programit, i preferueshëm të ndërmerret bashkërisht nga Danida dhe Qeveria Shqiptare, mund të kryhet edhe me kërkesën e ndonjë Pale tjetër.

5. Danida do të ketë të drejtën të kryejë monitorimin dhe vlerësimin sipas këtij Neni pas mbarimit të veprimtarive të projekteve të ndryshme ose të tërë programit.

Neni 11

Menaxhimi i Programit, Komiteti i Koordinimit të Programit

1. Gjithë përgjegjësia për menaxhimin dhe zbatimin e programit të të dy Qeverive do të jetë e Komitetit të Koordinimit të Programit të nivelit të lartë të specifikuar në nenin 12 të kësaj marrëveshjeje të mbështetur nga Koordinatori Danez i Programit.

2. Përgjegjësia për zbatimin e përditshëm të veprimtarive individuale të të dy Qeverive do të jetë e secilit nga Institucionet Shqiptare të mbështetura nga programi në nivelin qendror dhe e Komitetit Drejtues të Dibrës, që do të vendoset për Projektin Pilot të Dibrës, siç përcaktohet në Program Dokumentin.

3. Danida do të informojë vazhdimisht Komitetin e Koordinimit të Programit mbi projektet që do të zbatohen nga organizatat joqeveritare brenda kuadrit të ndihmës së tranzicionit.

Neni 12

Komiteti i Koordinimit të Programit

1. Komiteti i Koordinimit të Programit do të përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë nga Ministrinë dhe institucionet kryesore të përfshira në zbatimin e programit (Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Rendit, Ministria e Pushtetit Lokal), por Komiteti i Koordinimit të Programit mund të vendosë të ftojë përfaqësues nga institucionet ose organizatat e tjera të mbështetura në mbledhjet e tij, për shembull Kryetarin e Komitetit Drejtues të Dibrës. Koordinatori Danez rezident i Programit merr pjesë si sekretar.

2. Komiteti i Koordinimit të Programit do të mbledhet të paktën katër herë në vit, herën e parë menjëherë pasi kjo marrëveshje të hyjë në fuqi. Në mbledhjen e tij të parë, Komiteti i Koordinimit të Programit do të themelohet dhe do të miratojë Rregullat e Procedurave.

3. Komiteti i Koordinimit të Programit:

a) do të drejtojë dhe lehtësojë zbatimin e programit duke siguruar angazhimin e Qeverisë ndaj objektivave të Programit dhe përmbushjen në kohë të detyrimeve të Qeverisë në lidhje me Programin. Meqenëse një objektiv kryesor i Projektit Pilot të Dibrës është testimi i reformave të Qeverisë dhe legjislacionit të ri duke ndihmuar zbatimin dhe forcimin e tyre në Dibër, Komiteti i Koordinimit të Programit do të jetë përgjegjës për sigurimin e mbështetjes së nevojshme në nivel qendror për të lejuar që veprimtaritë të zbatohen në këtë mënyrë në praktikë;

b) do të diskutojë dhe miratojë planin e zbatimit të programit që do të përgatitet dhe rifreskohet rregullisht nga Koordinatori Danez i Programit;

c) do të monitorojë progresin e programit dhe të ndihmojë institucionet në kapërcimin e pengesave që dalin gjatë zbatimit të programit;

d) do të ndihmojë institucionet duke zhvilluar rrugë dhe mënyra për t'i bërë arritjet e mbështetjes Daneze të qëndrueshme;

e) do të përhapë informacionin për progresin e programit dhe mësimet e nxjerra tek institucionet e tjera qendrore dhe vendore dhe te donatorët me qëllim që të nxisë shfrytëzimin e arritjeve pozitive në zona të tjera dhe

f) do të përgatisë një raport që përmbledh propozimet për përdorimin e fondeve të paalokuara

për misionet vjetore të rishikimit.

Neni 13

Raportimi i Programit

Procedurat e mëposhtme do të përdoren për raportimin e veprimtarive, projekteve të ndryshme dhe të gjithë programit:

a) Komiteti i Koordinimit të Programit do të vërë në dispozicion të Danida-s dhe palës Shqiptare raporte progresi gjashtë-mujore jo më vonë se tre javë pas përfundimit të afatit të raportimit dhe do të përmbajë statusin financiar e fizik të veprimtarive dhe të projektit pilot. Raportet do të përpilohen në përputhje me Udhëzuesit e Danida-s dhe Palës Shqiptare për Raportimin e Progresit të Projektit.

b) Në përfundim të veprimtarisë, Komiteti i Koordinimit të Programit do të përgatisë një Raport të plotë Projekti, në përputhje me Udhëzuesit e Danida-s për këto Raporte.

Neni 14

Transferimi i pronësisë

1. Partnerët e Bashkëpunimit të veprimtarive të ndryshme do të mbajnë inventar të rifreskuar të të gjitha pajisjeve të tilla si strukturat fikse, makinat, kompjuterat, mobiljet dhe veglat, të dhuruara ose të blera për programin nga fondet e Qeverisë së Danimarkës.

2. Pajisjet, materialet, furnizimet dhe lehtësirat e financuara nga Qeveria e Danimarkës, të cilat përdoren gjatë zbatimit të programit, ndërmjet të tjerash makina, kompjutera, mobilje dhe vegla mbeten pronë e programit, derisa të dyja Palët të bien dakord ndryshe.

3. Transferimi i pronësisë mbi pasurinë e programit mund të bëhet gjatë periudhës së programit. Para mbarimit të programit të dyja Palët do të vlerësojnë dhe do të bien dakord për transferimin e një prone të programit e tillë që mund të justifikohet në bazë të një kërkesë përfundimtare nga institucionet marrëse. Çdo pronë që mbetet do të jetë në dispozicion të Danida-s.

4. Në rastin e punëve civile, objektet do të bëhen pronësi e projektit ose e veprimtarisë në datën e lëshimit nga konsulenti të certifikatës së marrjes në dorëzim.

Neni 15

Kushtet

Asistenca Daneze e programit do të bëhet efektive nëse dhe kur të plotësohen kërkesat e mësipërme sipas vlerësimit të Danida-s.

Neni 16

Pezullimi

1. Nëse do të vërehen çrregullime serioze ose dyshime brenda programit ose nëse krëkesat e domosdoshme të sipërpërmendura nuk përmbushen, çdo njëra nga Palët mund të ndërpresë tërësisht ose pjesërisht zbatimin e programit derisa Pala pezulluese të vendosë për vazhdimin e zbatimit.

2. Qeveria Daneze mund të anulojë Marrëveshjen nëse ajo konstaton se përsa i përket çdo kontrate të financuar nga fondet Daneze janë ndërmarrë praktika korrupsioni ose mashtrimi nga Pala përfituese e fondeve gjatë prokurimit apo ekzekutimit të kontratës, ose kur përfituesi i fondeve nuk ka marrë veprime të përshtatshme e në kohë, si dhe të kënaqshme për Qeverinë Daneze me qëllim zgjidhjen e situatës.

3. Nuk do të bëhet asnjë ofertë, pagesë, konsideratë apo përfitim i ndonjë lloji tjetër direkt ose indirekt, që konsiston në praktika ilegale apo korruptive motivimi, apo shpërblimi në lidhje me tenderimin, çmimin e kontratës dhe ekzekutimin e kontratës.

Praktika të këtij lloji do të shërbejnë si bazë për anulimin e menjëhershëm të kësaj kontrate dhe për veprime të tjera të karakterit civil ose kriminal sipas rastit. Sipas Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Danimarkës, një konsekuencë e mëtejshme e çdo praktike të tillë mund të jetë edhe përjashtimi definitiv nga çdo proces tenderimi për projektet e financuara nga qeveria Daneze.

Neni 17

Procedurat e kontabilizimit dhe revizionimit

1. Brenda 6-mujorit të përfundimit të vitit fiskal 2001 të Qeverisë Shqiptare, llogaritë e revizionuara do t'i dorëzohen Danida-s në përputhje me kushtet e rëna dakord në mënyrë të veçantë.

2. Përfaqësuesit e Qendrës së Përgjithshme të Auditimit të Danimarkës do të kenë të drejtën që të ushtrojnë çdo lloj revizionimi ose inspektimi që konsiderohet i nevojshëm në lidhje me përdorimin e fondeve në fjalë të Qeverisë Daneze, në bazë të dokumentacionit përkatës.

Neni 18

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi perkohësisht, në datën e nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e Qeverive të dy vendeve dhe përfundimisht me shkëmbimin e notave të ratifikimit sipas procedurave të secilit vend.

2. Programi do të ketë një kohëzgjatje trevjeçare. Në rast vonesash gjatë zbatimit të programit kohëzgjatja mund të shtyhet me marrëveshje dypalëshe brenda buxhetit të rënë dakord.

Neni 19

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet bisedimeve midis Palëve. Në rast se mosmarrëveshja nuk është zgjidhur brenda vitit, çështja mund t'i kalohet për arbitrim ndonjë Pale tjetër.

2. Arbitrazhi do të kryhet sipas rregullave që vijnë: Numri i arbitrave do të jetë gjithsej tre, një i përcaktuar nga secila Palë, domethënë, dy dhe një i tretë i përcaktuar nga dy të parët. Në rast mosmarrëveshjeje midis dy arbitrave të parë përse i përket përcaktimit të të fundit, atëherë arbitri i fundit do të përcaktohet nga një institucion neutral që do të identifikohet nga dy të parët. Vlerësimi i gjykimit do të vihet në dispozicion në formë të shkruar dhe duhet të nënshkruhet nga të tre arbitrat. Procedurat që do të ndiqen nga Gjyqi i Arbitrit do të vendosen nga të tre arbitrat, të cilët do të përcaktojnë ndarjen midis dy Palëve të kostos së arbitrazhit.

Neni 20

Përfundimi

Kjo marrëveshje do të mbetet në fuqi për tre vjet që nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje. Palët mund ta përfundojnë programin duke rënë dakord me një shkëmbim notash ose në mënyrë të njëanshme duke dërguar njoftim për përfundimin e kësaj marrëveshjeje. Një njoftim i tillë do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pasi të jetë marrë nga Pala tjetër.

Bërë në Kopenhagen më 2 qershor 1999 në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe në dy kopje origjinale në gjuhën anglisht, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, do të merret si referues teksti në gjuhën angleze.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë

Ermelinda Meksi

Ministër i Bashkëpunimit Ekonomik
dhe Tregtisë

Për Qeverinë e Mbretërisë së
Danimarkës

Poul Neilson

Ministër i Bashkëpunimit për Zhvillim